

Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit 27

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale

Objekti

- 1 Ky Standard do të zbatohet gjatë përgatitjes dhe paraqitjes të pasqyrave financiare të konsoliduara për një grup njësisish ekonomike nën kontrollin e një shoqërie mëmë.
- 2 Ky Standard nuk merret me metodat e kontabilitetit për kombinime biznesi dhe efektet e tyre në konsolidim, duke përfshirë dhe emrin e mirë që del nga një kombinim biznesi (shih SNRF 3 *Kombinime biznesi*).
- 3 Ky Standard do të zbatohet gjithashtu dhe në kontabilitetin për investime në filiale, njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe pjesëmarrje kur një njësi ekonomike ose zgjedh vetë që të paraqesë pasqyra financiare individuale ose kur një gjë e tillë i kërkohet nga rregullat lokale.

Përkufizime

- 4 Në këtë standard termat e mëposhtme janë përdorur me këto kuptime:

Pasqyra financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një grupi të paraqitura si pasqyrat financiare të një njësie të vetme ekonomike.

Kontroll është fuqia për të drejtuar politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të merren përfitime nga aktivitetet e saj.

Metoda e koston është një metodë e kontabilitetit për një investim, sipas të cilës investimi njihet me kosto. Investitori njihet të ardhura nga investimi vetëm në shkallën që investitori merr shpërndarje nga përfitimet e akumuluarat të investimit pas datës së blerjes. Shpërndarjet e marra përtej këtyre përfitimeve konsiderohen si mbulim i investimit dhe njihen si zbritje të koston për investim.

Një grup është një shoqëri mëmë dhe të gjitha filiale të saj.

Interesi i pakicës është ajo pjesë e fitimit ose humbjes dhe aktivet neto të një filiali që i atribuohen interesave të kapitalit neto që zotërohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet filialeve nga shoqëria mëmë.

Një shoqëri mëmë është një njësi ekonomike që ka një ose më shumë filiale.

Pasqyra financiare individuale janë pasqyrat financiare që paraqiten nga një shoqëri mëmë, një investitor në një pjesëmarrje ose një sipërmarrës në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht, në të cilën investimet janë llogaritur në bazë të interesit direkt të kapitalit neto dhe jo mbi bazën e rezultateve të raportuara dhe aktivet neto të njësisë ku është investuar.

Një filial është një njësi ekonomike, duke përfshirë dhe një njësi ekonomike të përgjithshme, si për shembull një ortakëri, e cila kontrollohet nga një njësi tjetër ekonomike (të njohur si shoqëria mëmë).
- 5 Një shoqëri mëmë ose filiali i saj mund të jetë investitore në një pjesëmarrje ose sipërmarrës në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht. Në raste të tilla, pasqyrat financiare të konsoliduara të përgatitura dhe të paraqitura në përputhje me këtë Standard gjithashtu përgatiten në mënyrë që të përputhen me SNK 28 *Investime në pjesëmarrje* dhe SNK 31 *Pjesëmarrje në Sipërmarrjet e Përbashkëta*.
- 6 Për një njësi ekonomike të përshkruar në paragrafin 5, pasqyra financiare individuale janë ato pasqyra të përgatitura dhe të paraqitura përveç pasqyrave financiare që përmenden në paragrafin 5. Pasqyrat financiare individuale nuk duhet t'i shtohen ose të shoqërojnë këto pasqyra.
- 7 Pasqyrat financiare të një njësi ekonomike që nuk ka interesin e një filiali, pjesëmarrje ose sipërmarrjeje në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht nuk janë pasqyra financiare individuale.
- 8 Një shoqëri mëmë që është përjashtuar nga paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me paragrafin 10, mund të paraqesë pasqyra individuale financiare si të vetmet pasqyra të saj financiare.

Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara

- 9 Një shoqëri mëmë e ndryshme nga një shoqëri mëmë e përshkruar në paragrafin 10 do të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara në të cilat ajo konsolidon investimet e saj në filiale në përputhje me këtë Standard.
- 10 Një shoqëri mëmë nuk i nevojitet që të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara nëse dhe vetëm nëse:
- (a) shoqëria mëmë është vetë një filial plotësisht i zotëruar, ose është një filial pjesërisht i zotëruar nga një njësi ekonomike tjetër dhe pronarët e tjerë të saj, duke përfshirë dhe pronarët që nuk kanë të drejtë vote, janë informuar dhe nuk kanë kundërshtime që shoqëria mëmë të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara;
 - (b) Instrumentat e borxhit ose kapitalit neto të shoqërisë mëmë nuk tregëtohen në një treg publik (një bursë e brendëshme ose e huaj ose tregje jashtë burse, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale);
 - (c) shoqëria mëmë nuk ka depozituar dhe as nuk është në proces të depozitimit të pasqyrave të saj financiare në një komision letrash me vlerë ose një organizatë tjetër rregullatore për qëllimet e emetimit të ndonjë klasë të instrumentave në një treg publik; dhe
 - (d) shoqëria mëmë përfundimtare ose e ndërmjetme e shoqërisë mëmë prodhon pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim nga publiku, të cilat janë në koherencë me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar.
- 11 Një shoqëri mëmë që në përputhje me paragrafin 10 zgjedh për të mos paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara, dhe paraqit vetëm pasqyra financiare individuale, respekton paragrafët 37–42.

Objekti i pasqyrave financiare të konsoliduara

- 12 Pasqyra financiare të konsoliduara do të përfshijnë filialet e shoqërisë mëmë.¹
- 13 Kontrolli prezumohet të ekzistojë kur shoqëria mëmë zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nëpërmjet një filiali, më shumë se gjysmën e fuqisë votuese të një njësie ekonomike, me përjashtim të rasteve kur, në rrethana përjashtimore, mund të demonstron qartë se një pronësi e tillë nuk mund të përbëjë kontroll. Kontrolli ekziston gjithashtu edhe kur shoqëria mëmë zotëron gjysmën ose më pak fuqi votuese të një njësie ekonomike kur ka:²
- (a) fuqi mbi gjysmën e të drejtave të votës nëpërmjet një marrëveshjeje me investitorë të tjerë;
 - (b) fuqi për të drejtuar politika financiare dhe operative të një njësie ekonomike sipas një statuti ose një marrëveshjeje;
 - (c) fuqi për të emëruar ose për të hequr shumicën e anëtarëve të bordit të drejtorëve ose të një organi tjetër ekuivalent qeverisës, dhe kur kontrolli i njësisë ekonomike bëhet nëpërmjet këtij bordi ose organi; ose
 - (d) fuqia për të dhënë shumicën e votave në bmlledhjet e bordeve të drejtorëve ose organit tjetër ekuivalent qeverisës dhe kur kontrolli i njësisë ekonomike bëhet nga ky bord ose organ.
- 14 Një njësi ekonomike mund të zotërojë garanci aksioni, opsione blerje aksionesh, instrumente borxhi ose kapitali neto që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme, ose në instrumente të tjera të ngjashme që kanë potencialin, nëse ushtrohen ose konvertohen, që t'i japin njësisë ekonomike fuqi votuese ose të zvogëlojnë fuqinë votuese të një pale tjetër për politikën financiare ose operative të një tjetër njësie ekonomike (te drejta votuese potenciale). IN10 Prania dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që ushtohen aktualisht ose janë të konvertueshme, duke përfshirë dhe të drejtat potenciale votuese të një njësie tjetër ekonomike, merren në konsideratë kur vlerësohet se njësia ka kompetencën që të drejtojë politikën financiare dhe operative të një njësie tjetër ekonomike. Te drejta votuese potenciale nuk janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme kur, për shembull, ato nuk mund të ushtrohen ose të konvertohen deri në një datë në të ardhmen ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje në të ardhmen.
- 15 Gjatë vlerësimit nëse të drejtat votuese potenciale japin kontribut në kontroll, njësia ekonomike shqyrton të gjitha faktet dhe rrethanat (duket përfshirë termat e ushtrimit të të drejtave të votimit potencial dhe cdo rregullim tjetër kontraktual të marrë në shqyrtim në mënyrë individuale ose në kombinim) që ndikojnë mbi të drejtat e votimit potencial, me përjashtim të qëllimit të drejtimit dhe aftësisë financiare për të ushtruar ose konvertuar.

¹ Nëse në blerje një filial i plotëson të gjitha kriteret e klasifikaurës si të mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktivitet Afatgjatë të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet jo të Vijueshme*, llogaritja do të bëhet në bazë të atij Standardi.

² Shih gjithashtu KIS-12 *Konsolidimi – Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta*.

- 16 [Fshirë]
- 17 [Fshirë]
- 18 [Fshirë]
- 19 Një filial nuk përjashtohet nga konsolidimi thjesht vetëm pse investitori është një organizatë me kapital të përbashkët, fond i përbashkët, njësi besimi ose një njësi ekonomike e ngjashme.
- 20 Një filial nuk përjashtohet nga konsolidimi për shkak se aktivitetet e tij të biznesit nuk janë të ngjashme me aktivitetet e njëjësive të tjera ekonomike brenda grupit. Informacioni i rëndësishëm jepet duke konsoliduar filiale të tilla dhe duke dhënë informacion shpjegues shtesë në pasqyrat financiare të konsoliduara rreth aktiviteteve të ndryshme të biznesit të filialeve. Për shembull, shënimet shpjeguese të kërkuara nga SNRF 8 *Segmente të Shfrytëzimit* ndihmojnë për të shpjeguar domethënien e aktiviteteve të ndryshme të biznesit brenda grupit.
- 21 Një shoqëri mëmë humb kontroll kur ajo humb fuqinë për të drejtuar politikat financiare dhe operative të investuarit në mënyrë që të merren përfitime nga aktivitetet e tij. Humbja e kontrollit mund të ndodhë me ose pa një ndryshim absolut ose relativ të niveleve të pronësisë. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur një filial bëhet objekt kontrolli nga një qeveri, gjykatë, administrator ose rregullator. Humbja e kontrollit mund të ndodhë dhe si rezultat i një marrëveshje kontraktuale.

Procedurat e konsolidimit

- 22 Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, një njësi ekonomike kombinon pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë dhe të filialeve të saj rresht për rresht duke mbledhur zëra të ngjashëm të aktiveve, pasiveve, kapitalit neto, të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mënyrë që pasqyrat financiare të konsoliduara të paraqesin informacion aktual financiar rreth grupit si një njësi e vetme ekonomike, ndërmerren veprimet e mëposhtëme:
- vlera kontabël neto e investimit të shoqërisë mëmë në secilin filial dhe pjesa e kapitalit neto të shoqërisë mëmë për secilin filial eliminohet (shih SNRF 3, i cili përshkruan trajtimin e ndonjë difference si emër i mirë);
 - Identifikohen interesat e pakicës në fitimin ose humbjen e filialeve të konsoliduara për periudhat e raportimit; dhe
 - Interesat e pakicës në aktivet neto të filialeve të konsoliduara identifikohen veçmas prej kapitalit neto të shoqërisë mëmë në to. Interesat e pakicës në aktivet neto përbëhen prej:
 - shuma e atyre interesave të pakicës në datën e fillestare të kombinimit e përlogaritur në përputhje me SNRF 3; dhe
 - pjesa e pakicës në ndryshimet në kapitalin që prej datës së kombinimit.
- 23 Kur ekzistojnë të drejtat votuese potenciale, pjesa e fitimit ose humbjes dhe ndryshimet në kapitalin neto që i shpërndahen shoqërisë mëmë dhe interesave të pakicës përcaktohen mbi bazën e interesave të pronësisë dhe nuk reflektojnë ushtrimin ose konvertimin e mundshëm të të drejtave votuese potenciale.
- 24 **Tepricat, transaksionet, të ardhurat dhe shpenzime brenda grupit do të eliminohen plotësisht.**
- 25 Tepricat dhe transaksionet, duke përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe dividendët brenda grupit eliminohen plotësisht. Fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i transaksioneve ndërmjet grupit që njihen në aktive, të tilla si inventarë dhe aktive afatgjata, eliminohen plotësisht. Humbjet ndërmjet grupit mund të dëshmojnë për një çylerësim që kërkon njohje në pasqyrat financiare të konsoliduara. SNK 12 *Tatimet mbi te ardhurat* zbatohet për diferencat e përkohshme që dalin nga eliminimi i fitimeve dhe humbjeve që vijnë si rezultat i transaksioneve brenda grupit.
- 26 **Pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë dhe të filialeve të saj, të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, do të përgatiten në të njëjtin datë raportimi. Kur data e raportimit të shoqërisë mëmë dhe e një filiali janë të ndryshme, filiali përgatit, për qëllime konsolidimi, pasqyra financiare shtesë në të njëjtën datë me atë të pasqyrave financiare të shoqërisë mëmë, në përjashtim të rasteve kur nuk është praktike të bëhet një gjë e tillë.**
- 27 Kur, në përputhje me paragrafin 26, pasqyrat financiare të një filiali, të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara përgatiten në një datë raportimi të ndryshme nga data e raportimit të shoqërisë mëmë, do të bëhen rregullime për efekte të transaksioneve ose ngjarjeve domethënëse që kanë ndodhur në periudhën midis kësaj date dhe datës së pasqyrave financiare të shoqërisë mëmë. Në cdo rast, diferenca ndërmjet datës së raportimit të filialit dhe datës së raportimit të shoqërisë mëmë nuk do të jetë më shumë se tri muaj. Gjatësia e periudhës së raportimit dhe çdo ndryshim në datat e raportimit do të jenë të njëjta nga njëra datë në tjetrën.

- 28 **Pasqyrat financiare të konsoliduara do të përgatiten duke përgatitur politika kontabël uniforme për transaksione dhe ngjarje të tjera të njëjta në rrethana të ngjashme.**
- 29 Nëse një anëtar i grupit përdor politika kontabël të ndryshme nga ato të përdorura në pasqyrat financiare të konsoliduara për transaksione të njëjta dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme, për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara bëhen rregullimet përkatëse në pasqyrat e tij financiare.
- 30 Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data e blerjes, siç parashikohet në SNRF 3. Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara deri në datën në të cilën shoqëria mëmë pushon së kontrolluar filialin. Diferenca midis shumave të rezultura nga nxjerrja jashtë përdorimi e filialit dhe vlerës së tij kontabël neto në datën e nxjerrjes jashtë përdorimit, duke përfshirë dhe shumat kumulative të cdo ndryshimi të këmbimit që lidhen me filialin e njohur në kapital neto në përputhje me SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit*, njihet në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave si fitim dhe humbje në nxjerrjen jashtë përdorimi të filialit.
- 31 **Një investim në një njësi ekonomike do të kontabilizohet në përputhje me SNK 39 *Instrumente financiare: Njohja dhe matja* nga data kur njësia nuk është më filial, me kusht që ajo të mos bëhet pjesëmarrje, siç përkufizohet në SNK 28, ose një njësi ekonomike e kontrolluar bashkërisht siç përshkruhet në SNK 31.**
- 32 **Vlera kontabël neto e investimit në datën që njësia ekonomike pushon së qëni një filial do të konsiderohet si kosto në matjen fillestare të një aktivi financiar në përputhje me SNK 39.**
- 33 **Interesat e pakicës do të paraqiten në bilancin e konsoliduar brenda kapitalit neto, vecmas nga kapitali neto i aksionerëve të shoqërisë mëmë. Edhe interesat e pakicës në fitimin ose humbjen e grupit do pasqyrohen vecmas.**
- 34 Fitimi ose humbja i atribohet aksionerëve të shoqërisë mëmë dhe interesave të pakicës. Për shkak se të dyja janë kapital neto, shuma që i atribohet interesave të pakicës nuk është e ardhur ose shpenzim.
- 35 Humbjet e aplikueshme për pakicën në një filial të konsoliduar mund të tejkalojnë interesin e pakicës në kapitalin neto të filialit. Teprica dhe humbjet e mëtejshme të aplikuarra për pakicat, mbulohen nga interesi i shumicës, me përjashtim të shumës për të cilën pakica ka një obligim të detyrueshëm dhe ka mundësi të bëjë një investim shtesë për të mbuluar humbjet. Nëse filiali në periudhat pasardhëse raporton fitimet, këto fitime i kalojnë interesit të shumicës deri sa të jetë mbuluar pjesa e humbjes e pakicës e mbuluar më parë nga shumica.
- 36 Nëse një filial ka në qarkullim aksione preferenciale kumulative të cilat zotërohen nga interesat e pakicës dhe klasifikohen si kapital neto, shoqëria mëmë llogarit pjesën e saj të fitimit ose të humbjes pas rregullimit për dividendët për këto aksione, pavarësisht nëse janë deklaruar ose jo dividendët.

Kontabiliteti për investime në filiale, njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe pjesëmarrje në pasqyrat individuale financiare

- 37 **Kur përgatiten pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe në sipërmarrjet që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten ose:**
- (a) me kosto, ose
- (b) në përputhje me SNK 39.
- I njëjti kontabilitet do të aplikohet për çdo kategori investimesh. Investimet në filiale, njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe sipërmarrjet që janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten në përputhje me këtë SNRF.**
- 38 Ky Standard nuk përcakton se cilat njësi ekonomike nxjerrin pasqyra financiare individuale të disponueshme për përdorim publik. Paragrafët 37 dhe 39–42 zbatohen kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Njësia ekonomike prodhon gjithashtu pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim të publikut, siç kërkohet nga paragrafi 9, në përjashtim të rastit kur është i zbatueshëm përjashtimi i përmendur në paragrafin 10.
- 39 **Investimet në njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe sipërmarrje që në pasqyrat financiare të konsoliduara llogariten në përputhje me SNK 39, do të llogariten në të njëjtën mënyrë në pasqyrat financiare individuale të investitorit.**

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 40 Në pasqyrat financiare të konsoliduara do të jepen informacionet shpjeguese të mëposhtëme:
- [Fshirë]
 - [Fshirë]
 - natyra e marrëdhënies ndërmjet shoqërisë mëmë dhe një filiali, kur shoqëria mëmë nuk zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet filialeve, më tepër se gjysmën e fuqisë votuese;
 - arsyet pse pronësia e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, nëpërmjet filialeve, e më tepër se gjysmës së fuqisë votuese ose të fuqisë potenciale votuese, nuk përbën kontroll;
 - data e raportimit të pasqyrave financiare të një filiali, kur pasqyra të tilla financiare përdoren për të përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara dhe data e raportimit dhe periudha e raportimit është e ndryshme nga ajo e shoqërisë mëmë, si dhe arsyet e përdorimit të një date ose periudhe të ndryshme raportimi; dhe
 - natura dhe niveli i kufizimeve domethënëse (psh që vijnë si rezultat i marrëveshjeve të huamarrjes ose i kërkesave rregullatore) mbi aftësinë e filialeve për transferim fondesh tek shoqëria mëmë në formën e mjeteve monetare, dividendëve ose ripagimit të huave ose parapagesave.
- 41 Kur përgatiten pasqyra financiare individuale për një shoqëri mëmë, e cila, në përputhje me paragrafin 10, zgjedh të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, këto pasqyra financiare individuale duhet të japin informacion shpjegues për:
- faktit që pasqyrat financiare janë pasqyra financiare individuale; që është përdorur përjashtimi nga konsolidimi; emri dhe vendi i themelimit ose rezidencës së njësisë ekonomike, pasqyrat financiare të konsoliduara të së cilës që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë prodhuar për përdorim të publikut; dhe adresa ku merren këto pasqyra financiare të konsoliduara;
 - një listë e investimeve më të rëndësishme në filiale, njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe sipërmarrje, duke përfshirë emrin, vendin e themelimit ose rezidencën, pjesën e interesit të pronësisë, dhe, nëse është e ndryshme, pjesën e fuqisë së votimit që zotëron; dhe
 - një përshkrim të metodës së përdorur për të llogaritur investimet e dhëna në listën në pikën (b).
- 42 Kur një shoqëri mëmë (e ndryshme nga një shoqëri mëmë e trajtuar në paragrafin 41), sipërmarrës me një interes në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht ose një investitor në një pjesëmarrje përgatit pasqyra financiare individuale, ato pasqyra financiare individuale duhet të jepen informacion shpjegues për:
- faktin që pasqyrat janë pasqyra financiare individuale dhe arsyet pse këto pasqyra janë përgatitur nëse një gjë e tillë nuk kërkohet prej ligjit;
 - një listë e investimeve më të rëndësishme në filiale, njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe sipërmarrje, duke përfshirë emrin, vendin e themelimit ose rezidencën, pjesën e interesit të pronësisë, dhe, nëse është e ndryshme, pjesën e fuqisë së votimit që zotëron; dhe
 - një përshkrim të metodës së përdorur për të llogaritur investimet e dhëna në listën në pikën (b).
- dhe do të identifikojë pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me paragrafin 9 të këtij Standardi, SNK 28 dhe SNK 31 me të cilat ato lidhen.

Data e hyrjes në fuqi

- 43 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Tërheqja e prononcimeve të tjera

- 44 Ky standard zëvendëson SNK 27 *Pasqyra Financiare të Konsoliduara dhe Kontabiliteti për Investimet në Filiale* (i rishikuar në 2000-in).

45 Ky Standard zëvendëson gjithashtu dhe KIS-33 *Konsolidimi dhe Metoda e kapitalit neto—Te drejta votuese Potenciale dhe Shpërndarja e Interesave të Pronësisë*.